

## Përse duhet të marrë pjesë fëmija im në HSU?

### Arsye të forta


Përmes HSU-së fëmija juaj do të ...

- promovohet në shumëgjuhësi
- thellohet në gjuhën e vendit të origjinës në të folur dhe në shkrim
- forcojë identitetin e tij
- zgjerojë aftësinë e tij ndërkulturore të veprimit
- marrë pjesë në fund të nivelit sekondar I në një provim gjuhe (rezultati shënohet në dëftesë në rubrikën „Arritjet“)

### Veçanërisht të kihet parasysh

**Shkolla e përkushtimit** është shkolla, ku zhvillohet HSU-ja.

**Shkolla e detyrueshme** është shkolla, e cila frekuentohet rregullisht nga nxënëset dhe nxënësit.



### Partneri i kontaktit në Seksionin e Arsimit

Angela Partner  
Këshillatare e shkollës  
Tel. 02336 / 93 22 30  
[a.partner@en-kreis.de](mailto:a.partner@en-kreis.de)

Alwiné Ometa  
Konsulente profesionale për integrimin  
Tel. 02336 / 93 22 29  
[a.omet@en-kreis.de](mailto:a.omet@en-kreis.de)

Botues  
Seksioni i Arsimit i Rrethit Ennepe-Ruhr

## Seksioni i Arsimit të Rrethit Ennepe-Ruhr

### Mësimi në gjuhën e vendit të origjinës



### Ecuria e procesit

### Informacione për prindërit

# Mësimi në gjuhën e vendit të origjinës (HSU)

## Mësimi në gjuhën e vendit të origjinës (HSU)

Të nderuar Prindër,

HSU-ja është një ofertë shtesë e landit NRW për nxënëset dhe nxënësit e klasave 1 deri 10 me histori imigrimi, të cilët zotërojnë tashmë **njohuritë bazë** në gjuhën e vendit të tyre të origjinës. Gjuhët dhe kultura e vendeve të tyre të origjinës të sjella me vete, janë pjesë e identitetit të tyre. Gjuhët kanë rëndësi të veçantë në zhvillimin e personalitetit të tyre. Për më tepër, shumëgjuhësia është një pasuri kulturore në një botë që rritet gjithnjë e më e fortë bashkërisht.

Mësimi zhvillohet pasditeve krahas mësimit të rregullt. Fëmijë nga shumë shkolla e zhvillojnë mësimin pjesërisht së bashku në një shkollë.

## Detyrat dhe qëllimet

Detyra e mësimit është, të krijojë dhe të ruajë aftësitë e të folurit dhe të shkruarit në bazë të planit mësimor për HSU-në, dhe të përcjellë kompetencat e rëndësishme ndërkulturore.

## Informacioni i shkolles

Shkolla ju informon gjerësisht juve si prindër të nxënësve dhe nxënësve me histori imigrimi lidhur me ofertën HSU.

## Regjistrimi

Regjistrimet bëhen jo më vonë se fillimi i vitit shkollor ose i gjysmë vitit shkollor, - më së voni brënda 4 javësh.

Luteni të plotësoni formularin e regjistrimit dhe t'a dorëzoni atë në sekretarinë e shkollës së **detyrueshme** ose tek mësuesit e HSU-së. Regjistrimi është i vlefshëm për të paktën një vit shkollor ose deri në ndërrimin e shkollës ose deri në çrregjistrim. Më pas, pjesmarrja në HSU është e detyrueshme.

## Pjesmarrja e detyrueshme

Në mësim vlen (si për çdo mësim tjetër në shkollë) pjesmarrja e detyrueshme. Mungesat do të shënohen në vërtetimin mbi pjesëmarrjen.

## Çrregjistrimi / Ndërrimi i shkollës

Pas regjistrimit, pjesmarrja në HSU është e detyrueshme. Çrregjistrimi është i mundur vetëm në fund të vitit shkollor për vitin e ardhshëm shkollor. Ai duhet të dorëzohet me shkrim në drejtorinë e shkollës së **detyrueshme** ose tek mësuesit e HSU-së.

Në rastin e ndërrimit të shkollës është i nevojshëm regjistrimi i ri në shkollën e re.

## Vërtetimi mbi pjesmarrjen

Vërtetimi mbi pjesmarrjen dorëzohet së bashku me dëftesën në ditën e shpërndarjes së dëftesave.

## Dëftesa

Nota ose vlerësimi mbi zhvillimin mësimor të fëmijës shenohet në dëftesë në rubrikën "Shënime".

## Mësuesit e HSU-së

Mësuesit që japin mësim në HSU janë punonjës të landit NRW. Ata janë të gjuhës amtare.